4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
A. Uniforma Shërbimi Dimërore.					
Kostum uniforme (xhaketë,pantallona,këmishë,kravatë,kapele,këpucë)					
1.	Xhaketë ngjyrë blu të errët	650			
2.	Pantallona ngjyrë blu të errët	650			
3.	Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë të kaltër	1300			
4.	Kravatë blu e errët	1300			
5.	Kapele blu e errët	1300			
6.	Këpucë gjysma, uniforme	650			
7.	Pulovër blu e errët golf me zinxhir	650			
8.	Xhup blu i errët	650			
9.	Xhiboks blu i errët	650			
10.	Këpucë me qafa	650			
11.	Bluzë e brenshme dimri e trikotuar, ngjyrë e zezë	1300			
12.	Bluzë me mëngë të gjata, blu e errët	1300			
13.	Pelerina e shiut	650			
14.	Doreza lëkure	650			
B. Uniforma Shërbimi vere					

Kostum uniforme(xhakëtë,pantallona,këmishë,kravatë,kapele,këpuçë)					
1.	Pantallona ngjyrë blu e errët	1300			
2.	Fund ngjyrë blu e errët	116			
3.	Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër	1300			
4.	Këpuçë gjysma vere (për meshkuj e femra)	650			
5.	Kapele tip sportive ngjyra blu e errët	1950			
6.	Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar, blu e errët	1300			
7.	Bluzë e brendshme verore, ngjyra e zezë	1300			
8.	Rrip mesi ngjyrë e zezë	650			
9.	Jelek fosfoeshent	300			
B/1 Uniforma e Shërbimit për përdoruesit e biçikletave (pantallona,bluzë,atlete)					
1.	Bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë e bardhë	100			
2.	Pantallona të shkurtra ngjyrë blu e errët	100			
3.	Atlete ngjyrë blu e errët	50			
C. Uniforma Ceremoniale. Kostum uniforme (xhakëtë,pantallona,këmishë,kravatë,kapele,këpuçë, shiritat,dorezat,rrip mesi+rrip krahëqafë)					
1.	Shiritat në formë gërsheti ngjyra (ari, argjendi, kaltër) me maja metalike	30			
2.	Doreza të bardha	60			
3.	Rrip mesi+rrip krahëqaf i bardhë	30			
D. Shënjet Dalluese					
1.	Shënja e supit (Spaleta me shirita ngjyrë ari, argjendi, kaltër)	1200			
2.	Shënja e gjoksit (Numër personal)	1200			
3.	Shënja e krahut	1918			
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

BLERJE UNIFORMA DHE VESHJE TË TJERA SPECIALE PËR POLICINË BASHKIAKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, pika 3/b, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Nëse ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN, mbi konformitetin e standardit evropian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

SPECIFIKIME TEKNIKE UNIFORMA E POL.BASHKIAKE

A. UNIFORMA E SHËRBIMIT DIMËROR

Kostum uniforme (xhakëtë, pantallona, këmishë, kravatë, kapele, këpucë)

1. Xhaketa e kostumit të uniformës ngjyra blu e errët

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kostumeve blu të Policisë Bashkiake.

Realizohen me tekstil të tezgjahur në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrave fizike (1 xhakëtë, me numër gjoksi 52; gjatësi trupore 170 ÷ 172 cm), të ndërtuar me materialet e poshtë shënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0.3 ml gjatësi lëndë e parë (stof blu) dhe sa gjerësia e tekstilit.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të tekstileve të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit	ISO 1833	53% Poliester (± 3%) 45% Lesh (± 3%) , cuklim I ultë 2% Eleastan (± 1%)
Ngjyra e xhakëtës		CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE< 1.5 (Blu e errët)
Masa	ISO 3801 PART III	320 g/m2 (± 5%)
Diametri i fijeve të leshit	ISO 137	22,5 µm (± 1 µm)
Endja (thurja diagonal)		Të ills (pëlhurë me vijëzim)
Numri i fijeve për cm	ISO 7211	Vertikal: 26/cm (± 1) Horizontal: 22/cm (± 1)
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 65 daN Horizontal: min. 45 daN
Cuklimi	ISO 12945-1	Pas 18.000 cikleve: 4 – 5 Pas 36.000 cikleve: 4 - 5
Qëndrueshmëria ndaj abrazionit	ISO 12947 -1,2/9Kpa	>20.000 cikle
Këndi i rikuperimit	ISO 2313	Vertikal: min. 150° Horizontal: min. 150°
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077	Vertikal: <1,5% Horizontal: <2,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105C06	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit) (me të thatë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në të lagësht)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrave gjatë pastrimit kimik	ISO 105 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4
Trajtimi final (angl.: finish) pluhurit		Zmbrapës i ujit, vajrave dhe
Testi i spërkatjes	ISO 4920	4
Zmbrapshmëria ndaj vajit	ISO 14419	4

Astari i xhepave të xhakëtës
Specifikat

Normat

Rezultatet

Përbërja e materialit	ISO 1833	65% Poliester (± 3%) 35% Pambuk (± 3%)
Ngjyra		Blu e errët
Masa	ISO 3801 PART III	110 g/m ²
Endja		Linen
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 60 daN Horizontal: min. 35 daN
Qëndrueshmëria e qepjeve në shkarje	ISO13936-1 në 3mm	Vertikal ≥ 100 N Horizontal ≥ 200 N
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077	Vertikal: <1,5% Horizontal: <1,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105C06	4 - 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4 - 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në të lagësht)	ISO 105 X12	4 - 5
Qëndrueshmëria e ngjyrave gjatë pastrimit kimik	ISO 105 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4 - 5




Khaketa Pamja para

Dizajni

Khaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët**, me spaleta me dimensione 13.5cm x 4 cm, për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa.

Në pjesën e përparme është e përbërë nga 4 xhepa: 2 janë në lartësinë e gjoksit e 2 lartësia e kindës me përmasa (si në figure) dhe 2 tegela midis xhepave të sipërm dhe të poshtëm, të cilat shërbejnë për të treguar formën e belit.



Përmasat e xhepit të xhaketës

Në krahun e majtë vendoset velkrov për shënjën e krahut me emblemën e Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Në pjesën e përparme mbi xhepin e vogël në krahun e djathtë vendoset velkrov për shënjën e gjoksit (numuri indetinfikimit).

Pjesa e përparme e tekstilit është e përfshirë me frazëlinë, te supet ka të vendosur vatinat të cilat japin formë në plotësinë e xhakëtës.

Në anën e parme janë katër vrima me gjatësi efektive 2,5 cm. Kopsa e parë fillon 1 cm nën linjën e poshtme të fillimit të jakës, vrima e 4 duhet të jetë e pozicionuar në një linjë me pjesën e sipërme të kapakut të xhepit, vrimat duhet të jenë në distancë të njëjtë, hapja e vrimave janë 1.6 cm nga buza para.

Te jaka vendoset elementi kryesor I stemë së Bashkisë Tiranë. Emblemat e jakës janë të përbëra nga metal i galvanizuar dhe vijnë në tre ngjyra, të artë, të argjendtë dhe blu.


Pjesa e brendshme është e përbërë nga astar dhe 2 xhepa në pjesën e gjoksit.

Gjerësia e filetosit është 4mm, e çila është qepur në pjesën perimetrale të jakës së sipërme si dhe në përthyerjen e mëngëve të xhakëtës.

Xhaketa për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë me kopsat në anën e majtë.

1/1 Stema e e jakës.

Stema e jakës do të jetë me gjerësinë 30 mm & me lartësinë 17 mm. Ajo do të prodhohet në 3 ngjyra, ngjyrën e artë, argjendë dhe blu lolite. Struktura e formës së bedenave të kalasë do të konfigurohet me basoreliev në mënyrë që forma e saj të jetë sa më e qartë.



Drejtuesi

Punonjës Inspektor, Polic

Përgjegjës i Sektorit

Struktura e stemës së jakës do të jetë e stampuar me material aliazh (bakër, kallaj, plumb dhe alumini). E galvanizuar në ngjyrë ari, argjendi dhe e ngjyrosur në blu lolite. Ajo duhet të ketë një mbrojtje kundër oksidimit. Në pjesën e mbrapme të saj do të ketë dy kunjë metalike të brazlanguara në formën e spile, të cilat do të futen në jakën e xhakëtës dhe do të fiksohen nga mbrapa me kapëse shtrënguese.

2. Pantallonat ngjyra blu e errët

<i>Specifikat</i>	<i>Normat</i>	<i>Rezultatet</i>
Përbërja e materialit	ISO 1833	53% Poliester (± 3%) 45% Lesh (± 3%) , cuklim I Ultë 2% Eleastan (± 1%)
Ngjyra e pantallonave		CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE < 1.5
Masa	ISO 3801 PART III	Blu e errët 320 g/m2 (± 5%)
Diametri i fijeve të leshit	ISO 137	22,5 µm (± 1 µm)
Endja (thurja)		Të ill (pëlhurë me vijëzim diagonal)
Numri i fijeve për cm	ISO 7211	Vertikal: 26/cm (± 1) Horizontal: 22/cm (± 1)
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 65 daN Horizontal: min. 45 daN
Cuklimi	ISO 12945-1	Pas 18.000 cikleve: 4 – 5 Pas 36.000 cikleve: 4 - 5
Qëndrueshmëria ndaj abrazionit	ISO 12947 -1,2/9kPA	>20.000 cikle
Këndi i rikuperimit	ISO 2313	Vertikal: min. 150° Horizontal: min. 150°
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077	Vertikal: <1,5% Horizontal: <2,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	5

Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105 C06	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në të lagësht)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrave gjatë pastrimit kimik	ISO 105 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4
Trajtimi final (angl.: finish)		Zmbrapës i ujit, vajrave dhe pluhurit
Testi i spërkatjes	ISO 4920	4
Zmbrapsmëria ndaj vajit	ISO 14419	4

Astari i xhepave te pantallonave


Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit	ISO 1833	65% Poliester (± 3%) 35% Pambuk (± 3%)
Ngjyra		Blu e errët
Masa	ISO 3801 PART III	110 g/m ²
Endja		Linen
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 60 daN Horizontal: min. 35 daN
Qëndrueshmëria e qepjeve në shkarje	ISO13936-1 në 3mm	Vertikal ≥ 100 N Horizontal ≥ 200 N
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077	Vertikal < 1,5% Horizontal: < 1,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105 C06	4 – 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4 – 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në të lagësht)	ISO 105 X12	4 – 5
Qëndrueshmëria e ngjyrave gjatë pastrimit kimik	ISO 105 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4 – 5



Pamja para



Pamja prapa



fundi

Dizajni

Pantallonat do të jetë ngjyra blu e errët, janë model klasik, me dy xhepa të përpamë diagonale (të pjerrëta në anë), me një xhep në pjesën e pasme, mbyllja e pantallonave është me zinxhir, pantallonat janë me shtrat të lartë.

Qemeri është e përbërë nga 6 ylykë. Dy xhepat anësor kanë një hapje prej 17 cm dhe hapsirë prej 3 cm. Dy xhepa të pasëm janë pa kapak me fileto.

Mbyllja e xhepit është me kopsa të thjeshta. Qemeri i pantallonave është i pajisur me dopio astar i adzivuar në pjesën e brendshme të qemerit është e montuar një shirit gome dy mm i cili shërben për mbajtjen sa më mirë të pozicionuar të këmishës. Lartësia e qemerit është 4 cm.

Mbyllja e pantallonave bëhet me kapse metalike. Fileto dekoruese me dimensione 4 mm duhet të vendosen në pjesën anësore të pantallonave në më të buzëve.

Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë përveç modelimit ,i cili duhet të jetë për femra.

3. Këmishë me mëngë të gjata ngjyra e kaltër

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave me mëngë të gjata ngjyra e kaltër të Policisë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrave fizike (këmishë nr. 41/42 dhe dy jaka të gatshme) e prodhuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me 0.3ml gjatësi lëndë e parë (tekstil bojë qielli) dhe sa vetë gjerësia e tekstitit. Të dy anët e tekstitit të jenë të mbyllura në formë të rregullt.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve do të shërbejnë si bazë për prodhim .

Mostrat duhet të jenë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të tekstileve të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi i tekstitit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstitit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratorit duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Specifikimet	Normat	Të dhënat
Përbërja	ISO1833	60% Pambuk 40% Poliester
Ngjyra		TPX 15-3930
Masa	EN12127	114g/m2(±5g)
Dendësia	UNIEN1049/2	45*45
Numri I fijeve		TELAPOUPLIN
Stabiliteti dimensional pas larjes në 40°C	ENISO26330	Vertikal: ±2% Horizontal:±2%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ENISO105B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C	ISO105-C01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	ISO105-X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në lagështi)	ISO105-X12	3-4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës, acideve dhe alkaleve	ISO105-E04	4

Materiale të tjera:

Jaka, manshetat dhe kapakët e xhepave duhet të jenë pajisur me mes-astar të mesëm (vendosur në mes të pëlhurave). Kopsat janë me katër vrima për qepje.



Pamja Para

Dizajni

Këmisha me mëngë të gjata do të jetë ngjyra e kaltër. Pjesa e përparme e këmishës është e punuar me një shirit me gjerësi 3 cm. Buza e pjesës ballore është e qepur 5 mm.

Qepja e pjesës së përparme është e qepur nga një tegel, duke filluar nga buza e qepur e supeve për të kaluar përmes qendrës së xhepit në gjoks. Jaka e punuar është moderne dhe ka një gjerësi mesatare. Jaka është qepur 5 mm nga buza.

Spaletat mbi supe jena me dimensione 13,5 x 4 cm. Çdo spaletë përfundon në një pullë, duke pasur kujdes për të siguruar që spaletat të janë të vendosura në qendër të supeve. Shiritat e spaletave jena të qepura 5 mm ngabuza. Mbërthimi i këmishës bëhet jo më pak se 7 (shtatë) kopsa.

Këmisha ka mëngë të gjata, dhe një hapje prej 18 cm. Manshetat janë 7 cm në gjerësi, me buzët qepura 5 mm nga skajet dhe mbërthehen përmes një kopse. Pjesa e shpinës (supeve) është 9 cm poshtë nga qendra e qafës

Në krahun e majtë vendoset velkrov për shënjën e krahut me emblemën e Bashkisë Tiranë me mbishkrimin "POLICIA BASHKIAKE". Në pjesën e përparme mbi shepin e vogël në krahun e djathtë vendoset velkrov, për shënjën e gjoksit.

Këmisha për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë me kopsat në anën e majtë.

4. Kravata blu e errët

Specifikat

Përbërja e materialit

Ngjyra e Kravatës

1.59 (Blu e errët)

Ngjyra e Shiritit

Endja

Masa

Masa/ njësi gjatësie

Cuklimi

Këndi i rikuperimit

Qëndrueshmëria ndaj abrazionit

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës

Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (në të lagësht)

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj materieve kimike

Normat

ISO 1833

ISO 3572

ISO 3801 PART III

ISO 7211/5

ISO 12945-1

ISO 2313

ISO 12947 -1,2/9Kpa

ISO 105 B02

ISO 105 C06

ISO 105 X12

ISO 105 X12

ISO 105 D01

Rezultatet

100% Poliester

CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE<

L* 16.58 a* 1.05 b*-6.35

19-4056 TPX Blu Lolite

Satin 5

115 g/m2 (± 5 g)

Vertikal: 85dtex (±3%)

Horizontal: 120dtex (±3%)

Pas 9.000 cikleve 5

Pas 18.000 cikleve 4 – 5

Vertikal: min. 145°

Horizontal: min. 145°

20.000 cikle


5


4

4

4

4





Dizajni

- Kravat ka kapëse të cilësis solide
- Kravata do të ketë një shirit të hollë të kaltër i cili do të nisët nga maja e poshtme e kravatës deri në afërsi të nyjes
- Kravata dekorohet nga një shirit të kaltër do të jetë me diametër 2-3 mm , thurja do të jetë e thurrur në tekstil me stilin “Jackart”qe e pershkon diagonalisht dhe gjithashtu nga emblema e Bashkisë Tiranë.
- Nyja është e gjerë 6 – 8 cm dhe 3- 4 cm e thellë
- Gjerësia ne piken me te gjere duhet te jete 7- 7,5 cm

5. Kapele e Kostumit të Uniformës ngjyra blu e errët

Këto specifikime përcaktojnë kërkesat cilësore për prodhimin e kapeles të kostumit terital të Policisë Bashkiake me ngjyrë blu e errët.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (një kapele masa 56),për femra dhe për meshkuj me logon e Bashkiasë Tiranë, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, Mostra e sjellë nga prodhuesi dhe të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas kërkesave do të shërbejë si bazë për prodhimin e pantallonave.

Mostrat e sjella duhet të jenë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të tekstileve të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratorit duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

➤ Dizajni i kapeles uniformës për meshkuj



Pamja anash**Pamja para****Pamja anash**

Kapela e kostumit të uniformës është me ngjyrë blu të errët, është një kapelë e formatit “peaked”. E pozicionuar në pjesën e përparme të kapelës është emblema e Bashkisë Tiranë.

Ka shirit me ngjyrë argjendi në pjesën përpara. Ky shirit qëndron me hijeshi midis dy linjave elegante blu, duke theksuar më tej pamjen e rafinuar të kapelës.

Kapela ka një shirit të brendshëm me viskozë dhe resinë antibakteriale, në ngjyrën e zezë, si dhe vrima për ajrosje H = 4.5 mm.

Ka katër vrima në të dy krahët anësorë, 2 +2 me percina. Në brendësi ka një sustë elastike për të mbajtur strehën në pozicion.

Kordoni në ngjyrat argjend, me lartësi 10 mm vendoset mbi strehën e kapeles dhe montohet me dy kopsa metalike fiksuese anësore.

Dy kopsat fiksuese anësore mbesin në përkatësinë në ngjyrë argjendi.

Kapelja përbëhet gjithashtu nga susta tubolare perimetrare e cila shërben për të mbajtur tekstin perimetral të pjesës së sipërme të kapeles në formë të tendosur të rrethit gjithashtu nga frazelina e brendshme e cila duhet të përforcojë tekstin në një qëndrim permanent të formës së kapeles. Astar i brendshëm ka material 100% viskoze.

Përmasat e Kapelese masa 51	
Lartësia e kurorës	7-8 cm
Perimetri i kokës	54 cm
Perimetri i tavanit	47-48cm
Gjatësia e strehës përpara	6.5- 7cm
Gjatësia e strehës prapa	5.5 cm
Gjatësia e strehës anash	7 cm
Perimetri i strehës (ehapur)	78-80cm

Kapela do të prodhohet në masat 51—60 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë Bashkiake.

➤ **Dizajni i kapeles uniformës për Femra**



Pamja anash



Pamja përpara



Pamja anash

Pjesët përbërëse të kapelës:

1. Tavano i kapelës (pjesa e sipërme e kapelës)
2. Kurora

-
3. Streha
 4. Brendia
 5. Fileto cilindrike dekorative ngjyrë blu errët.
 6. Kopsat metalike anësore
 7. Stema
 8. Shiriti ngjyrë argjend.

Tavani i kapelës duhet të ketë formë ovale. Ajo duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) dhe një shtresë tekstili poliestër në fromë rrjete ikollarisur për t'i dhënë formë kapelës.

Kurora e kapelës duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) dhe një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë kapelës.

Kurora duhet të qepet në pjesën e pasme të kokës.

Lartësia e kurorës duhet të ndryshojë në varësi të masës së kapelës.

Astari i brendshëm i kapelës duhet të jetë i bardhë me material 100% poliestër. Ai duhet të veshë të gjithë brendinë e kapelës.

Streha e kapelës duhet përbëhet nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) me përmasa të barabarta të përforcuara secila me nga një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë strehës.

Shtresat e strehës duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me anë të 9 tegelave linearë një gjilpërësh sipërfaqësorë në largësi çdo 5 mm.

Pjesët anësore të strehës duhet të qëndrojnë të palosura dhe të fiksuara në anë të kurorës. Në të majtë dhe në të djathtë kurorës vendoset nga një kopsë metalike.

Shirit prej lëkure. Tek buza e poshtme e fashës rrethore të kapelës duhet të qepet njëshirit perimetral prej lëkure që shërben për mbrojtjen e kapelës nga djersët. Buza e sipërme e shiritit duhet të jetë e lirë. Shiriti duhet të jetë prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje.

Midis fashës rrethore dhe shiritit perimetral prej lëkure duhet të qepet një fije plastike përforcuese perimetrale me trashësi 0.5 mm që ndihmon ruajtjen e formës së kapelës.

Etiketa me emrin e prodhuesit duhet të qepet tek astari i tavanit

5/1 **Emblema e kapeles**

Emblema e kapeles dot të ketë emblemën e Bashkisë Tiranë me formë si në figurë e katalogut ka dimensione 65 mm vertikal & 35 mm horizontal. Emblema do të ketë konture në pjesën perimetrale me ngjyrë të artë me diametër 1 mm.

Struktura e emblemës do të jetë material tunxh i stampuar, ku të gjitha elementët e spiërpermen- duara do të jenë të stampuara me basoreliev dhe ngjyrat e sipër përmendura (me logon e Bashkisë Tiranë) do të implemntohen në basoreliev sipas modelit. Pjesa e mbrapme do të ketë dy ganxha me 4 kunjë metalike të vetë materialit tunxhë të brazlanguara në formën spile, të cilat do të hynë në brendësi të kapeles dhe do të fiksohen nga mbrapa me kapëse shtrënguese.



Pamja para

6. Këpucë gjysma uniforme

Këto specifitime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këpucëve gjysma uniforme , lëkure, dimri për Policinë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike, një palë këpucë nr. 41-42, të ndërtuara me materialet e poshëshënuara, të shoqëruar me një pjesë lëndë e parë 30 x 20 cm, lëkurë vaqet cilësi e parë + astar meshin dhije cilësi e parë.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe të miratuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Këto këpucë mbrojnë këmbët gjatë dimrit pasi janë të ndërtuara me material lëkurë të përpunuar kundër ujit, vajrave, agjentëve kimikë dhe reflektimi ndaj diellit për të mbajtur nxehtësinë e këmbëve



Materialët që do të përdoren për prodhim

- Faqe natyrale (vaqetë) cilësi e parë, kromato, tip “ U ” me trashësi 1,9 – 2,2 mm.
- Astar meshin dhije 0,9 ÷ 1,1m/m për të gjitha pjesët e brëndëshme. Lejohet me trashësi 0,7 ÷ 0,9 m/m në faqet e brëndëshme e të përparme .
- Taban soleti (lëkurë natyrale).

- Kamaretë çeliku e mbuluar me kartonfibër të presuar.
- Penj sintetik mbi 9 kg. nr. 40/3 – 30/3 për qepjen e syprinës.
- Mbyllja e syprinës me tegela dopio ose 4 copë butona për palë.
- **Bombë termoplastike për pjesën e majës.**
- **Fortesë termoplastike ose karton i presuar i posaçëm për prapshtinën.**
- **Fjapë gome të presuar me trashësi 2, 5 ÷ 2.8 mm.**
- **Xhiro gome të presuar, trashësia 2, 5 ÷ 2.8 mm.**
- **Shollë gome të presuar (nga poshtë me llokma të dhëmbëzuara). Trashësia pa llokma: 7÷8 mm, me llokma: 12 ÷ 13 mm.**
- **Taka e këpucës me llokmën, lartësia 22 ÷ 23 mm, ndërsa bashkë me hapsirën qëshoqërohet me xhiron e gomës, lartësia e takës do të jetë 28 ± 1 m/m.**
- **Penj sintetik fill 1 m/m me rezistencë 38 kg për qepjen e fjapës me tabanin.**
- **Ngjitës me një komponent për ngjitjen e fjapës me tabanin.**
- **Ngjitës me dy komponent për ngjitjen e fjapës me gomën (shollën).**
- **Me gjashtë vrima me size në të dy anët për kalimin e lidhsave në formë kordoni.**
- Lartësia e qafës së këpucës 100 ± 1 m/m mbi xhiron e gomës.
- **Semenca makine me gjatësi 8÷9 m/m për mbërthim të faqes së këpucës me tabanin nëpjesën e prapme .**
- **Në pjesën e prapme të qafës së këpucës vendoset sfungjer me gjerësi 15 mm, midis astarit dhe lëkurës, të qepur brënda jashtë me penj sintetik.**

TE LEKUREVE NATYRALE (VAQETE TIP "U") PER KEPUCE GJYSMA (S. SH. 1143 – 89).

- Trashësia	1.9 ÷ 2.5 mm
- Yndyra në %	8 ÷ 11 %
- Qëndrueshmëria e plasjes së faqes 10 Mpa (kg/mm ²)	1.6
- Rezistenca ndaj këputjes së faqes	2.0
- Qëndrueshmëria deri në këputje në %.	÷ 70
- Penetrimi i ujit, jo më pakë se:	240' (4 orë)

SHOLLE GOME DHE FJAPË GOME TE PRESUAR:

- Fortësia (në gradë shores): Sholla	85 ± 3
Fjapa	75 ± 3

7. Pulovër blu e errët golf me zinxhir

Këto specifitime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të pulovrës së Policisë Bashkiake. Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike(një pulovër një bluzë me nr jake 41/42), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të vlersuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstitit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratorit duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit	ISO 1833	50% Lesh (± 3%) 50% Akryl (± 3%)
Ngjyra		Blu e errët (sikurse uniformat e punës)
Endja	ISO 2060/72	Half Milano
Diametri i fijeve të leshit	ISO 137	30 – 35 µm (± 1 µm)

Forca e këputjes së fijeve	ISO 2062	min 650 cN
Cuklimi	ISO 12945-1	Pas 7.000 cikleve: 4
Qëndrueshmëria në abrasion	ISO 12947-1, 2	30.000 cikle
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077, ISO 6330 30°C DRY Method C,ISO3759	10* 7A max. - 6%,+2%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës paslarjes në 30°C	ISO 105 B02	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të lagtë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj pastrimit kimik	ISO 150 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4



Pamja para

DIZAJNI

Pulovra e trikotuar duhet të ketë formë në përputhje me vijat e trupit (Full Fashioned)

Thurja - Trupi dhe mëngët – HALF MILANO RIB Gauge 7

Hapja – Golf me zinxhir .

Mëngët janë të ngjitura ose të lëshuara. Jakë golf me lartësi prej 70 mm, është e lidhur ose e vazhduar. Brinjëzimi i manshetës dhe fundi me thellësi prej 6,5 cm dyfishohet,ka prerje të qëndrueshme dhe të fiksuar mirë për dimër.Brinjëzimi i manshetës me thellësi prej 6,5 cm, është ‘jersey’ sikurse edhe trupi 2,5 cm për verë.

Ka përforcime doku në bryla dhe supe,me spaleta doku me dimensione 13,5 x 4 cm.Në krahun e majte vendoset velkrof për vendosjen e stemës Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Në krahun e djathtë përpara vensoet velkrof për shënjën e gjoksit.Pesha totale për madhësi standatrde është 640sg (± 20 g)

8. Xhup blu i errët

Këto specifitime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhupit blu i errët të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore 170 ÷ 172 cm, prerja III), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0,3 ml gjatësi lëndë e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjerësia e tekstilit. Të dy anët e tekstilit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të tekstileve të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi i tekstit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit		3 shtresa Shtresa e parë – 100%poliestër Shtresa e dytë – PTFE Shtresa e tretë – rrjetë me material poliester që
shërben		për mbrojtjen e shtresës PTFE Pesha e shtresës së tretë është 33 g/m ²
Ngjyra e xhupit		CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE< 1.5, Blu e errët.
Ngjyra e Shiritit		L* 16.58 a* 1.05 b*-6.35 19-4056 TPX Blu Lolite(kaltër)
Masa	ISO 3801	170 g/m ² (±5%)
Endja	ISO 3572	Të ill 2/2
Tkurrja në larjes 5x40°C	ISO 6330 4N, F	Vertikal: ≤3% Horizontal: ≤3%
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: 80 daN Horizontal: 70 daN
Rezistenca në grisje	ISO 4674-1 meth B	Vertikal: >32 N Horizontal: >30 N
Testi i spërkatjes	ISO 4920	≥4 – 5
Testi i spërkatjes në larje 3x 40 °C ISO 6330 6N+F	ISO 4920	≥3 – 4
Vlera RET	ISO 11092	≤12 m ² Pa/Ë
Kolona e ujit	ISO 20811	≥ 10 m
Kolona e ujit pas 5x40 °C + tharja ISO 6330 4N+F	ISO 20811	≥ 10 m
Kolona e ujit në shiritin e qepjes	ISO 6330 4N+F	≥ 2 m për 2 minuta
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 40 °C	ISO 105 C06C15	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë dhe me të thatë)	ISO 105 X12	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës në hekurosje në 110°C	ISO 105 X11	3 – 4




Pamja para



Pamja prapa

Dizajni

Xhupi përmban një dizajn të integruar me dy nuanca. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Pjesa poshtëme ngjyra blu e errët, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Mëngët së bashku me jakën janë ngjyrë blu e errët. Në pjesën e përparme ka një linjë pëlhure fotolumineshente, e cila siguron shikueshmëri më të madhe në kushte me dritë të ulët ose në errësirë. Në anën e djathtë poshtë shiritit të gjoksit vendoset velcro për të vendosur shenjën e gjoksit (numri i



identifikimit), ndërsa në mëngën e majtë Stema e Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Si model Në pjesën e pasme të xhupit, ka një shenjë të dallueshme që lexon "POLICIA BASHKIAKE" e punuar në pëlhurë argjendi fotolumineshente, duke siguruar identifikim dhe dukshmëri të qartë.

Tekstili i jashtëm

3 shtresa laminimi dhe astar ‘lio’, konform standardit OEKO-TEX 100 për materialet e përdorura.

Shtresëzimi (laminimi)

Materiali i jashtëm dhe membrana janë të lidhura së bashku në mënyrë të përherëshme, nuk duhet të delaminohen (të hiqen shtresat e tekstit), të ketë vrima ose flluska > 3 mm, edhe atëherë kur përdoren për një periudhë të gjatë kohore. Lidhja e shtrësëzuar duhet të përballojë një test shërbimi gjatë një cikli të pandërprerë të larjes prej 200 orësh (makinë shtëpiake për larjen e rrobave me një test të veçantë të vazhdueshëm larje, pa detergjent sipas ISO 6330 tipi A, pa tharje të ndërmjetme, sipas metodës së fundit të tharjes A ose 50 cikle larje sipas ISO 6330 4N dhe tharjes suksesive F).

Jaka

Pjesa e jashtme dhe e brendshme e jakës, si dhe jaka e ndërmjetme janë punuar nga tekstili i shtresëzuar në atë menyrë që sigurojnë hapsirë për vendosjen e një kapele të papërshkueshme nga uji. Jaka përforcohet me ngjitës me material jo të endur. Jaka e jashtme ka vëllim shtesë për të ruajtur

lehtë kapelën. Lartësia e jakës së kthyer mbrapshtë në patentin e sipërm ballor është rreth 9.5 cm. Jaka mbyllet përpara duke përdorur panele mbuluese dhe kopsa të papërshkueshme nga uji. Të dy panelet zgjaten deri në skajin e sipërm të jakës. Qepja e jakës/ qafës bëhet në pjesën anësore, qepjet në shtresën e jashtme janë të salduara. Jaka e jashtme dhe nënjaka fiksohen në tegelin e jakës/qafës me 3 iliqe. Një mjet i qëndrueshme për varje është qepur në pjesën e brendshme të qepjes së jakës, në qendër të shpinës.

Pjesa e përparme – pasme

Xhupi përbëhet nga dy pjesë, pjesën e përparme dhe pasme. Në pjesën e përparme poshtë shiritit djathtas vendoset velkrof për të vendosur shënjën e gjoksit (numëri I indentifikimit).

Në pjesën e pasme sfondi i shiritit duhet të jetë I njëjtë me atë të tekstit, copa reflektuese me ngjyrë të argjent reflektuese, kurse mbishkrimi ‘POLICIA BASHKIAKE’ me ngjyre të njëjtë si të jakës .

Shiritat për spaleta.

Shiritat me maje të spaletave janë me dimensione 13,5 x 4 cm. Secila spaletë përfundonë me një kopsë shtypëse të papërshkueshme nga uji, e fiksuar në pjesën e poshtme të tekstit të shiritave të spaletave. Vëmendje të veçantë i kushtohet shiritave të spaletave të jenë të vendosura në qendër të supeve. Hapja efektive duhet të jetë 11 cm.

Mëngët

Mëngët janë të punuara nga tre pjesë, me një pjesë nën sqetull për më shumë liri lëvizjeje. Gjerësia e pjesës nën sqetull është 8 cm. Manshetat janë të rregullueshme përmes një shiriti i cili mbyllet me material vlcro ose ekuivalent. Brenda mëngës është vendosur mansheta e thurur, e lidhur me tekstil të papërshkueshme nga uji.

Mbyllja e Xhupit

Mbyllja e xhupi bëhet përmes një zinxhiri nga plastika me hapje dydrejtësh. Zinxhiri shtrihet deri tek buza e sipërme e jakës dhe duhet të mbulohet nga shiritat ballor (panelet) me gjerësi të përafërt rreth 8cm. Shiriti i përfundshëm (kanali i shiut), kur jakna është e mbyllur, qëndronë përmbi afro 1,5 cm. në shiritin (panelin) për mbulim. Panelet duhen mbyllur me butona me presim të papërshkueshëm nga uji.

Kapela

Xhupi është e pajisur me një kapelë, e qepur në vend në tegelin e qafës. Kapela mund të shpaloset nga jaka. Pjesa e pasme e kapelës është e pajisur me spango elastike për përshtatje.

Xhepat e vendosur në gjoks

Djathtas dhe majtas me nga një xhep gjoksi me zinxhir, të pajisur me kapak. Në krahun e majtë qëndron emblema se policisë bashkiake.

Xhepat e vendosur anësorë

Xhupi është i pajisur me dy xhepa anësorë majtas dhe djathtas të mbuluar me kapak xhepi dhe të mbyllur me një zinxhir. Skajet e xhepave duhet siguruar nga grisja përmes qepjeve siguroese. Qepjet e xhepave janë mbyllur përgjithmonë me një shirit të përshtatshëm saldimit. Xhepat janë të përpunuar nga i njëjti material sikurse materiali I xhupit dhe janë të pajisur në pjesën anësore me hapje për drenim (kullim).

Xhepi “Napoleon”

Nën panelin e për mbulim pranë zinxhirit frontal në nivelin e gjoksit qëndron I inkorporuar një xhep i ashtuquajtur “Napoleoni”, i cili mbyllet me anë të një zinxhiri.

Xhepat e brendshëm

Një xhep i brendshëm vendoset në kulmin e hapjes së mëngëve. Hapja e xhepit është përafërsisht 17 cm i gjatë dhe të mbyllet duke përdorur një mbërthyes velcro ose ekuivalent. Thellësia e xhepit është përafërsisht. 18 cm

Astari

Mushamaja është e pajisur plotësisht (deri në mansheta) me një astar të mbushur me tegela. Astari në pjesën e trupit është me peshë 160 g/m², RCT Izolim Termik sipas DIN EN 31092/ISO 11092: 0.32 kurse në pjesën e mëngëve 80 g/m² RCT Izolim Termik sipas DIN EN 31092/ISO 11092: 0.20. Astari është i fiksuar përrrëshëm te xhupi. Etiketa e prodhuesit me të dhëna është qepur nën jakë në qendër të shpinës.

9. Xhiboks blu i errët

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhiboks blu i errët, të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (1 xhiboks, numur gjoksi 52, gjatësi trupore 170 ÷ 172 cm, prerja III), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0, 3 ml gjatësi lëndë e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjerësia e tekstilit. Të dy anët e tekstilit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të tekstileve të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit g/m ²		3 shtresa 100% mikrofibra sintetike 20D – 33
Ngjyra e shirtit		Blu Lolite (19-4056TPIX)(kaltër)
Ngjyra e Xhupit		CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE< 1.5 Blu e errët L* 16.58 a* 1.05 b*-6.35
Masa	ISO 3801	170 g/m ² (±5%)
Endja	ISO 3572	Tëiil 2/2
Tkurrja në larjes 5x40°C	ISO 6330 4N, F	Vertikal: ≤3% Horizontal: ≤3%
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: 80 daN Horizontal: 70 daN
Rezistenca në grisje	ISO 4674-1 meth B	Vertikal: >32 N Horizontal: >30 N
Testi i spërkatjes	ISO 4920	≥4 – 5
Testi i spërkatjes në larje 3x 40 °C	ISO 4920	≥3 – 4
ISO 6330 6N+F		
Vlera RET	ISO 11092	≤12 m ² Pa/Ë
Kolona e ujit	ISO 20811	≥ 10 m
Kolona e ujit pas 5x40 °C + tharja	ISO 20811	≥ 10 m
ISO 6330 4N+F		
Kolona e ujit në shiritin e qepjes	ISO 6330 4N+F	≥ 2 m për 2 minuta
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 40 °C	ISO 105 C06 C15	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë dhe me të thatë)	ISO 105 X12	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës në hekurosje në 110° C	ISO 105 X11	3 – 4

ASTARI

Specifikat

Përbërja e materialit

Ngjyra

Masa

Thurja

thurur

Zgjerimi në larje në 5 x 40°C

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje në 40°C

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës

Qëndrueshmëria e ngjyrës djersës

Normat

ISO 3801

ISO 3572

ISO 5077

ISO 105 X12

ISO 105 X12

ISO 105 B02

ISO 105 E04

Rezultatet

Poliester 100%

Blu lolite(kaltër)

100 g/m2 (±10 gr)

70 Den Vertikal rrjetë e

≤5%

4

3 - 4

4

4



Pamja para



Pamja prapa

Dizajni I Xhiboksit

Xhiboksi blu i errët përmban një dizajn të integruar me dy nuanca. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë një pjesë ngjyrë blu e errët dhe pjesa tjetër e kaltër. Jaka është blu e errët. Pjesa poshtëmë ngjyra blu e errët, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Në pjesën e përparme ka një linjë pëlhere fotolumineshente, e cila siguron shikueshmëri më të madhe në kushte



me dritë të ulët ose në errësirë. Në anën e djathtë poshtë shiritit të gjoksit vendoset velcro për të vendosur shënjen e gjoksit (numri i identifikimit). Si model në pjesën e pasme të xhiboksit, ka një shenjë të dallueshme që lexon "POLICIA BASHKIAKE" e punuar në pëlhurë argjendi fotolumineshente, duke siguruar identifikim dhe dukshmëri të qartë

Tekstili i jashtëm

3 shtresa laminimi me astar në formë rrjete, duke konfirmuar standardin OEKO-TEX 100. Të gjithë tegelat në lidhje me materialin e jashtëm konsistojnë prejme shirit ngjitës.

Shtresëzimi (laminimi)

Materiali i jashtëm dhe membrana janë të lidhura së bashku në mënyrë të përhershme, nuk duhet të delaminohen (të hiqen shtresat e pëlhurës), të ketë vrima ose flluska > 3 mm, edhe atëherë kur përdoren për një periudhë të gjatë kohore. Lidhja e shtresëzuar duhet të përballojë një test shërbimi gjatë një cikli të pandërprerë të larjes prej 200 orësh (makinë shtëpiake për larjen e rrobave me një test të veçantë të vazhdueshëm larje, pa detergjent sipas ISO 6330 tipi A, pa tharje të ndërmjetme, sipas metodës së fundit të tharjes A ose 50 cikle larje sipas ISO 6330 4N dhe tharjes suksesive F).

Jaka

Jakë me dy shtresa me qëndrim, jaka e jashtme dhe e poshtme është punuar nga tekstili i shtresëzuar dhe i përforcuar me ngjitës në jakën e jashtme duke përdorur material jo të endur. Jaka mbyllet në pjesën e përparme nga panel mbulues dhe pulla të papërshkueshme nga uji. Të dy panelët mbulues zgjaten deri tek buza e poshtme e jakës. Një mjetë i qëndrueshme për varje është qepur në pjesën e brendshme të qepjes së jakës, në qendër të shpinës.

Pjesa e përparme – pasme

Xhupi përbëhet nga dy pjesë, pjesën e përparme dhe pasme. Në pjesën e përparme poshtë shiritit djathtas vendoset velkrof për të vendosur shënjen e gjoksit (numëri I indentifikimit) Në pjesën e pasme, në shpinë, është një shirit i gjerë me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”, copa duhet të jetë me ngjyrë të argjent reflektuese.

Shiritat për spaleta

Shiritat me majë të spaletave janë me dimensione 13,5 x 4 cm. Secila spaletë duhet të përfundojë me një kopsë shtypëse të papërshkueshme nga uji, e fiksuar në pjesën e poshtme të pëlhurës të shiritave të spaletave. Vëmendje të veçantë duhet kushtuar që shiritat e spaletave të jenë të vendosura në qendër të supeve. Hapja efektive duhet të jetë 11 cm.

Mëngët

Mëngët janë të punuara nga tre pjesë, me një pjesëz nën sqetull për më shumë liri lëvizjeje. Gjerësia e shtojcës nën sqetulla duhet të jetë 8 cm. Manshetat janë të rregullueshme përmes një shiriti i cili mbyllet me material Velcro ose ekuivalent. Brenda mëngës duhet të jetë e vendosur mansheta e thurur, e lidhur me pëlhurë të papërshkueshme nga uji. Në mëngën e majtë është vendosur velcrov për të vendosur Stemën e Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”.

Mbyllja e xhupit

Mbyllja e xhupit bëhet përmes një zinxhiri nga plastika me hapje dydrejtimësh. Zinxhiri shtrihet deri tek buza e poshtme e jakës dhe vazhdon deri në 2 cm mbi pjesën e poshtme të jakës (shiriti i belit), dhe duhet të mbulohet nga shiritat ballor (panelet), Shiriti I përfundshëm (kanali i shiut), kur xhupi është i mbyllur, duhet të qëndrojë përmbi rreth 1,5 cm. në shiritin (panelin) për mbulim dhe atë të përfundshëm janë të vendosur 5 butona të fshehur dhe me presim të papërshkueshëm nga uji.

Hapjet anësore

Në të dy qepjet anësore, xhupi duhet të jetë e pajisur me hapje për të pasur qasje në armë, të cilat hapen me ndihmën e një zinxhiri duke filluar nga fundi. Shiriti i jashtëm duhet të jetë i pajisur me një copëz rripi për të mbyllur në fund përmes një butoni.

Xhepat e vendosur në gjoks

Djathtas dhe majtas me nga një xhep gjoksi me zinxhir, të pajisur me kapak. Xhepi djathtë në gjoks duhet të jetë i pajisur me një shirit me mbishkrimin POLICIA BASHKIAKE, kurse në të majtë një shirit për vendosjen e emblemës së policisë. Të dyja këto sipas nevojës duhet të kenë mundësi për tu futur në xhep.

Xhepat e vendosur vendosur anësorë

Xhupi duhet të jetë e pajisur me dy xhepa anësorë majtas dhe djathtas të mbuluar me kapak xhepi dhe të mbyllur me një zinxhir. Skajet e xhepave duhet siguruar nga grisja përmes qepjeve siguroese. Qepjet e xhepave janë mbyllur përgjithmonë me një shirit të përshtatshëm saldimi. Xhepat janë të përpunuar nga i njëjti material sikurse materiali xhupit dhe janë të pajisur në pjesën anësore me hapje për drenim (kullim).

Xhepat e vendosur brendshëm

Në anën e majtë duhet të jetë i vendosur një xhep në lartësinë e hapjes së mëngës. Hapja e xhepit duhet të jetë përafërsisht 17 cm ndërsa thellësia duhet të jetë rreth 18 cm. Hapja dhe mbyllja e xhepit bëhet me Velcro / Velcro (ose ekuivalent).

Astari

Xhupi është e pajisur plotësisht (deri në mansheta) me një astar rrjetë. Astari duhet të jetë i fiksuar në tërë jaknën në mënyrë të pandryshuar. Një etiketë e prodhuesit duhet të jetë e qepur nën jakë, në qendër të shpinës.

10. Këpucë me qafa

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këpucëve me qafa, trupe për Policinë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike, një palë këpucë nr. 41-42, të ndërtuara me materialet e poshëshënuara, të shoqëruar me një pjesë lëndë e parë 30 x 20 cm, vaqet cilësi e parë.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe të miratuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë e qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Lëkurë

Këto këpucë mbrojnë këmbët gjatë dimrit pasi janë të ndërtuara me material lëkurë të përpunuar kundër ujit, vajrave, agjentëve kimikë dhe reflektimi ndaj diellit për të mbajtur nxehtësinë e këmbëve.

Pjesa poshtë e këpucës është me material gomë të shkrirë për të siguruar jetëgjatësinë e këpucës. Është ndërtuar me sistemin e harkut për të ruajtur pozicionin natyral të këmbës në lëvizje dinamike.

Trashësia e LËKURËS: 1,8–2,0 cm. Me mbrojtës gishtash (peshë të lehtë) dhe Tre shtresa materiali GORE-TEX Certifikuar sipas: CEENISO 20345:2011; Klasa e sigurisë: S3

Materialet që do të përdoren për prodhim:

<i>Qëndrueshmëria e materialit të sipërm</i>	≥ 120N	ENISO 20345-5.4.3
<i>Forca dhe elasticiteti materialit</i>	≥ 15 N/ mm ²	ENISO 20345 – 5.4.4

<i>Resistenca dinamike ndaj ujit:</i>	Koha për penetrim nga uji ≥ 60 min	ENISO 20345-6.3.1
<i>Absorbimi i ujit pas 60'</i>	$\geq 30\%$; penetrim midis 60' and 90' jo më shumë se 0.2 gr	
<i>pH</i>	≥ 3.2	ENISO 20345 – 5.4.7
<i>Rift</i>	Asnjë deformim deri në 50,000 cycles	ENISO 20345-5.4
<i>Forca e shqyerjes së veshjes së brendshme</i>	≥ 2.0 Kgf	ENISO20345–5.5.1
<i>Rezistenca ndaj konsumimit</i>	>25.600 cikle të thata >12.800 cikle të lagura	ENISO20345–5.5.2



Këpucë me Qafa

11. Bluzë e brendshme dimri e trikotuar, ngjyrë e zezë.

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Bluzës të brendshme të trikotuar të dimrit të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (një bluzë me nr jake 41/42), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të vlersuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.


Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Përbërja	100 % pambuk
Ngjyra	CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE <1.5 L* 16.58 a* 1.05 b* 6.35
Filli	Ne 93/84 $\pm 5\%$
Pesha	150 $\pm 5\%$ g/m ²
Resistenca ndaj shperthimit	≥ 250 Kpa
Resistenca ndaj abrazionit	≥ 45.000 ciikle a Kpa 9 e presionint

Resistenca ndaj pilling	≥ 4 a 20.000 giri
Resistenca ndaj copezimit	> 8 N
Variacioni dimensionalne larje domestike	shkurtimi max 4 % ngushtimi max 4%
Qendrueshmeria engjyrosjes	drita e di- pastrim kimik: 4 ≥ larja në 60 ° C: ≥ 4 djersa: 4 ≥ fërkim i thatë: 4 ≥ fërkim i lagësht: 4 ≥
Pershkueshmeria e ajrit	≥ 900 mm/s
Koeficienti i transmetimit të avujvetë ujit	≥ 8.000 g/d*m ²
Aftësitë antibakteriale pas 50 ciklesh larjeje nëlavatriçe në 60 ° C	Reduktimi i ngarkesës\ bakteriale të shtameve të mëposhtme ≥ 75%:
SIMBOLET E PËRKUJDESJES	



Pamaja para



Pamja prapa

DIZAJNI

Jaka është realizuar e modeluar me formë jake rumbullake me ngjyrë të zezë. Në pjesën përpara në anën e majtë sipër, vendoset stema e Bashkisë Tiranë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Pjesët e bluzes bashkohen në linjën anësore. Linja fundore e bluzes si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën e pasme përfundon me një kthim pale me lartësi rreth 18- 20 mm të realizuar me tegel linear dy gjilpërësh. Mëngët janë të gjata dhe në pjesën fundore të tyre përfundojnë me kthim pale me lartësi rreth 18- 20 mm me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh.

12. Bluzë me mëngë të gjata blu e errët.

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Bluzës me mëngë të gjata blu e errët të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (një bluzë me nr jake 41/42), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.


Mostra e sjellë nga prodhuesi e të vlersuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

1	ISO3801:2013	Përcaktimi i Masës	200-220 g/m ² ±5%
2	ISO7211/1:1984	Përcaktimi i llojit të thurjes	Syth Irlandez
3	ISO1833,5088	Përcaktimi i përbërjes	80%CO 20%PES
4	ISO105-C03:1989	Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstit ndaj larjes në40°C	NOTA4-5
		SIMBOLET E PËRKUJDESJES	



Pamja para

DIZAJNI

1. PJESËT PËRPARA DHE PRAPA

Bluza ndërtohet me tekstil me ngjyrën blu të errët, e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë Tiranë me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, velcrov për shenjën e gjoksit. (numrit të identifikimit). Pjesa përparme e plotë dhe ajo pasme e plotë duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me te gjilpërësh të përforcuar nga brenda me te gjilpër është syzator. Në fund, bluza mbyllet me një palosje me lartë sirta rreth 2.5 cm. Palosja qepet me të gjilpërësh të dygjilpërësh. Pjesët "e çara" anësore janë të larta 4 cm dhe përforcohen me te gjilpërësh të lineare njëgjilpërësh në sipërfaqë, nga çdo anë.

Fundi i bluzës është drejtë dhe ka të njëjtën gjatësi në të dyja anët. Në linjën e supave janë spaletat që përfundojnë me kulm në majë, me dimensione 13,5 x 4 cm. Spaletat mbyllen me kopës plastike .

2. JAKA

Jaka ndërtohet me tekstil trikotazh me thurje elastik 1:1 në drejtim vertikal dhe lartësi standarde 8 cm. Bashkimi i dy pjesëve të bluzës bëhet me anë të një filetoje prej pambuku me gjerësi rreth 1 cm. Qepja e filetos tek jaka bëhet me anë të dy tëgëla lineare njëgjilpërësh. Ajo fillonë dhe mbaronë në gjysmën e gjerësisë së bordurave dhe vrimave të kopsave. Bordura e kopsave të masës M për meshkujt duhet të ketë përmasa 4x14 cm, ndërsa për femrat 3x13 cm. Pjesa e poshtme e bordurës së kopsave është mbivendosur me copë blu .

Bluza për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

13. Pelerina e shiut

Këto specifitime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Pelerinave të shiut të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (një pelerinë shiu nr. gjoksi 52/3, gjatësi trupore 170 -172), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të vlersuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar

Analizat sipasstandardeve EN - ISO*	Metodat e testimeve
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009
Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës	
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019
Tekstile - Analizat kimike sasioreose	
CEN ISO/TR 11827:2016	
Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimii fibrave	
Thurja	ISO 7211- 1: 1984
Tekstilet -Pëlhurat e endura.	
Hollësia e fijos	ISO 7211-5: 1984
Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi –	
Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi	
i dendësisë lineare të fijeve të hequranga pëlhura.	
Masa gr/m2	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005
Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimii masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.	
EN ISO 2286-2:2016	

Tekstile të gomuar ose të plastifikuara -Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave

Përshkueshmëria e ujit

(presioni hidrostatik)

EN ISO 4920:2012

Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim)EN 20811/

EN ISO 811:2018

Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit testi nën presionin hidrostatik

Aftësia ajërosëse e tekstilit

EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike në ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur ngadjersitja)

EN ISO 105- E01: 2013

Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë

engjyrës -

Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës

ndaj ujit

Qëndrueshmëria e Ngjyrës

EN ISO 105-E04 :2013

Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e

ngjyrës

- Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës

ndaj djersës acide

dhe alkaline EN ISO 105 - X12: 2016

Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e

ngjyrës -

Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim,

në të thatë dhe në

të lagur.

Qëndrueshmëria e Ngjyrës

EN ISO 105- B02: 2014

(rrezatimi UV)

Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës -

Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale:

Testi me llambë me harkksenoni

Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016
Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale	
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005
prirjes	Tekstilet - Përcaktimi i
shprishur	Së pëlhurave për të
pushëzuar	sipërfaqen dhe për t'u
- Pjesa 2: Metoda e	
modifikuar Martindale Materialet reflektive	
EN ISO 20471: 2013/A1:2016	
dheveshjet për	Standardi për shiritat reflektivë
	sigurinë në punë.
Azo Ngjyruet duhet paraqiten	Për produktin e gatshëm
spas standarteve:	rezultatet e këtyre testeve
	a. EN ISO 14362-1:2017
	b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

MATERIALET

- Produkti përfundimtar është identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës ka ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek Specifikimet Teknike.
- Tegelat e qepjes të mushamasë janë me hap 5 shpime në 1 cm.
- Tegelat janë të drejtë, uniformë, simetrikë dhe nuk kanë shqepje ose difekte.
- Tegelat janë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave është mbi 12 N.
- Tegelat janë të përforcuar në ekstremitete.
- Tegelat qepës janë me termosaldim.
- Të gjithë elementët e mushamasë janë simetrikë.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi bënë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument.
- Tekstili ka rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet. Tekstili ka veti hidrofobike.

- Tekstili ka rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili ka rezistencë maksimale ndaj përkushmërisë së erës dhe ujit dhesiguronë ajërim të mirë të trupit. (EN 343 klasa 3)
- Pelerina është e lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e mushamasë është $\pm 2\%$.
- Elementëve Velcro nuk duhet t'i dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Përproduktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017 c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është
- 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0

DIZANJI

Pelerina e shiut është me **ngjyrë të zezë**. Pelerina në pjesën përpara në anën e majtë sipër, ka stemën e Bashkisë Tiranë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin "POLICIA BASHKIAKE". Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardsesyje, e padepërtueshme nga uji, era dhe me kapuç të lëvizshëm.

Pelerina e shiut është e përbërë nga këto elemente :

- Dy pjesët e përparme
- Pjesa e pasme
- Jaka
- Dy mëngë të gjata të tipit *reglan*
- Një kapuç i lëvizshëm



Pamja përpara



Pamja prapa

1. PERPARA

Dy pjesët përpara janë prej materiali poliamid të padepërtueshëm ndaj ujit, me prejre përgjatë linjës qendrore. Dy pjesët bashkohen me anë të 5 preçinave me sustë , të kromuara.

a. Pjesa e majtë e veshur

Paraqet një bordurë të brendëshme (palosje) me formë drejtëkëndore përgjatë pjesës qendrore në të gjithë gjatësinë e saj. Bordura e brendëshme është realizuar me dy shtresa tekstili me gjerësi rreth 5 cm, realizuar me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Përgjatë aksit qendror të saj në distancë rreth 2 cm nga ana e jashtëme janë aplikuar pesë preçina " femër ", rreth 18 cm nga njëra –tjetra (vlerë e ndryshueshme në bazë të prerjes). Bordura e brendëshme e quajtur ndryshe dhe palë është e përshkuar në drejtimet e lira me anë të tegelit qepës një gjilpërësh rreth 5 mm dhe bashkohet me jakën dhe nën jakën në pjesën e sipërme me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Po në të majtë të

veshur, mbi bordurën e brendëshme është montuar një bordurë e sipërme (palosje) e aplikuar përgjatë gjithë gjatësisë së mushamasë me gjerësi totale rreth 6 cm. Bordura e sipërme është realizuar me tekstil dopio të padepërtueshëm nga uji, me gjerësi rreth 6 cm. Është e përbërë nga copë tekstili dopio e papërshkueshme nga uji, me gjerësi rreth 5 cm.

Pesë preçina me sustë në distancë rreth 2 cm nga ana e jashtme dhe në distancë rreth 18 cm nga njëra –tjetra. Kokat e preçinave janë montuar në pjesën e poshtme të bordurës së jashtme dhe janë të padukshme pasi janë montuar ndërmjet dy shtresave; ndërsa preçinat “ femër ” janë montuar në brendësi të tekstit poliamid.

b. Pjesa e djathtë e veshur.

Ashtu si pjesa e majtë dhe pjesa e djathtë e veshur është realizuar me anë të një bordure teke të realizuar me tekstil të njëjtë. Në bordurën e djathtë, në distancë rreth 2 cm nga ana e jashtme dhe rreth 18 cm nga njëra – tjetra, përgjatë aksit qendror janë montuar pesë preçina të përbëra nga dy pjesë “ mashkull ”, njëra e dukshme dhe tjetra e montuar në palosjen e brendëshme. Bordura është e përshkuar në drejtimet e lira me anë të tegelit qepës një gjilpërësh rreth 5 mm dhe bashkohet me jakën dhe nënjakën në pjesën e sipërme.

Qëllimi i kësaj mbyllje të veçantë qëndron në faktin se duke realizuar një mbyllje të tillë evitohet depërtueshmëria e ujit nga brenda duke bërë të korrespondojnë precinat “femër” të pjesës së majtë të veshur me ato “mashkull” të montuara në brendësi të pjesës së djathtë të veshur; më pas një mbyllje me anë të preçinave “mashkull” nga jashtë të pjesës së djathtë në korrespondencë me precinat “femër” të mostrës në të majtë të veshur, duke realizuar në këtë mënyrë një mbyllje totalisht të padepërtueshme të ujit.

Në dy pjesët përpara përgjatë linjës së belit janë aplikuar dy xhepa të brendshëm të gjerë, me kapak të realizuar me tekstil dopio në pjesën e sipërme në drejtim transversal me dimensione; gjatësi rreth 19 cm. Astari i xhepit është realizuar me tekstil dopio ka lartësi rreth rreth 4 cm dhe gjatësi rreth 20 cm i borduar me anë të tegelit qepës një gjilpërësh përgjatë gjatësisë, ndërsa anët e shkurtëra janë përforcuar me anë të tegelit qepës dy gjilpërësh.

Të gjithë tegelat qepës janë fiksuar me anë të shiritit izolues, të padepërtueshëm nga uji.

Linjat fundore të mushamasë dhe mëngëve, kanë një kthim pale rreth 2 cm.

2. PRAPA

Është realizuar me tekstil me përbërje poliamidi të papërshkueshëm ndaj ujit, është me një pjesë. Përgjatë linjës së shpinës është realizuar një stampë fosforeshente, ngjyrë gri e argjentë, me shkrimin me gërma kapitale “ POLICIA BASHKIAKE ” me stampim me lartësi 8 cm (kjo lartësi është e ndryshueshme në bazë të prerjes).

Prapa gjithashtu, në dy linjat anësore, janë aplikuar dy çarje në drejtim vertikal me lartësi totale rreth 46 cm. Në pjesën e poshtme të çarjes është aplikuar një shirit velkrof “mashkull” me gjerësi rreth 5 cm. Pjesa e sipërme e çarjes është formuar nga një palosje nga i njëjti tekstil me atë të mushamasë me gjerësi rreth 7 cm, në brendësi të së cilës është aplikuar një shirit velkrofi “ femër ” me push përgjatë gjithë gjatësisë së çarjes. Velkrofi ka gjerësi rreth 5 cm. Bashkimi i dy anëve të çarjes realizohet me anë të këtyre velkrofeve.

2. MËNGËT

Janë model “ Reglan ” dhe bashkohen me trupin e mushamasë nëpërmjet tegelit qepës në drejtim diagonal. Mëngët janë me një pjesë, të modeluara dhe bashkohen me anë të tegelit të poshtëm si dhe është aplikuar shiriti izolues përgjatë tegelit .

Në lartësinë e palosjes në distancë rreth 8,5 cm nga njëra- tjetra janë aplikuar dy preçina: një “ mashkull ” dhe një “ femër ”, të cilat të bashkuara ndërmjet tyre bëjnë të mundur shtrëngimin e kyçit të dorës në rreth 1/3 e perimetrit.

Tek mëngët vendoset shirit fosforeshent ne ngjyrë gri të argjentë , rrethore, me gjerësi 3 cm..

4. JAKA

Është realizuar me tekstil dopio të njëjtë me atë të mushamasë; ekstremitetet fundore të së cilës përfundojnë me majë. Jaka bashkohet me pjesët përpara dhe pjesën mbrapa me anë të tegelit qepës

një gjilpërësh. Tre drejtimet e lira të jakës janë përshkruar me anë të tegelit linear perimetral në distancë rreth 5 mm nga bordet. Në ekstremitetin në të majtë të veshur në distancë rreth 1 cm nga bordi është aplikuar një almar (gjuhëz) në formë drejtkëndor i realizuar me të njëjtin tekstil dopio, me gjatësi rreth 10 cm dhe gjerësi rreth 2.8 cm . Në ekstremitetin e almarit si në pjesën përpara ashtu dhe prapa është realizuar velkrof “ femër ” me push me gjerësi rreth 2 cm dhe gjatësi rreth 4 cm për anë. Rreth 6 cm prapa almarit (gjuhëzës) është aplikuar një velkrof “ mashkull ” me dimensione 2 x 4 cm. I njëjti velkrof “ mashkull ” është aplikuar dhe në ekstremitetin e jakës në të djathtë të veshur rreth 6 cm nga bordi, duke bërë të mundur kështu mbylljen e jakës nëpërmjet almarit (gjuhëzës) në të majtë të aplikuar. Në brendësi të jakës, përgjatë linjës fundore të saj është aplikuar një shtresë tekstili me të njëjtin tekstil e quajtur ndryshe dhe nënjakë, e cila përfundon me një kthim pale të brendshme të montuara me anë të tegelit qepës. Në pjesën e jashtëme të afërsi të tegelit bashkues të jakës me trupin e pelerinës, janë montuar tre preçina “mashkull”; të pozicionuara dy në skajet, ndërsa një i pozicionuar përgjatë linjës qendrore. Këto tre preçina shërbejnë për montimin e kapuçit të heqshëm.

5.KAPUÇI

Është realizuar me të njëjtin tekstil si ai i mushamasë i padepërtueshëm nga uji. Është i përbërë nga dy pjesë në dy gjysmë koka të modeluara, të montuara me anë të tegelit qepës një gjilpërësh me shirit izolues i cili shërben mos depërtimin e ujit dhe është përshkruar nga tegeli qepës perimetral. Në linjën fundore me përjashtim të anëve të përparme në distancë rreth 13 cm është realizuar një kthim pale rreth 3 cm. Përgjatë kësaj linje janë aplikuar tre preçina “ femër ” në korrespondencë me tre preçinat “ mashkull ”, të aplikuar në jakë.


Pelerina e shiut e kompletuar me të gjithë elementet, marketohet qartë me shkrim me anë të një etikete tekstili të qepur në pjesën e brendëshme në qendër të bashkimit të kapuçit me shpinën dhe që përmban: emrin e firmës prodhuese, numurin dhe fraksionin e prerjes së mushamasë dhe vitin e prodhimit.

Paketimi i artikulli “ **Pelerinë shiu** ” bëhet duke e palosur dhe e futur mushamasë brenda në qese **PVC**-je transparente. Futen në kuti sipas numurave dhe menjë sasi të caktuar dhe vulosen nga firma përkatëse. Shkruhet sasia dhe viti prodhimit.

Etiketimi


Në pjesën e brendshme të pelerinës në pjesën e brendshme të xhepit të majtë janë aplikuar etiketat e mëposhtme :

- Etiketa me demonstrimin e firmës furnizuese
- Etiketa me udhëzimet e prerjes
- Treguesi i përbërjes së tekstit, viti i fabrikimit dhe instruksionet e larjes (mirëmbajtja).



Këto instruksione janë aplikuar dhe në etiketën në pjesën e brendëshme të xhepit në të djathtë të veshur.

Normat e larjes :



Artikulli “ Pelerina e shiut ” konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

TABELA E MASAVE
(PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

	XS	S	M	L	XL	XXL	XXXL	4XL
1/2 e Perimetrit të kraharorit (e matur nën sqetull) .	57	61	65	69	73	76	80	84
Gjatësia e përgjithshme e pelerinës (nga supi deri në linjën fundore).	97	104	115	122	127	132	137	142
Gjatësi mënge (e matur nga pjesa e sipërme).	73	76	79	82	85	86	86	86

14. Doreza lëkure femra , meshkuj

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Dorashkave meshinit të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike(një palë dorashka nr.9 për femra,meshkuj), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të vlersuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si bazë për prodhim.

Mostra duhet të jetë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të materialit të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Dorashkat për femra dhe meshkuj janë njësoj në material dhe ngjyrë, përveç modelimit, i cili është sipas gjinisë përkatëse.

Pjesët përbërëse të dorashkës:

1. pjesa e kurrizit dhe e pëllëmbës
2. gishti i madh
3. shiritat mes gishtave
4. astari prej pellushi

Dorashkat e dimrit janë të zeza, prej lëkure dhe me pjesë shtesë mes gishtave.

Pjesët e qepura nuk janë të tërhequra ose me rrudha. Tek kurrizi i dorashkës qepen tre penca dekorative me fill prej pambuku të tipit pearl.

Ekstremitetet e pencave janë më afër njëra-tjetrës për nga drejtimi i kyçit dhe më larg njëra - tjetrës për nga drejtimi i gishtave.

Buza e lirë e qafës paloset nga brenda rreth 5 mm dhe të qepet me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Dorashkat shtrëngohen tek qafat me llastik të qepur në brendësi.

Dorashkat janë të veshura me astar prej pellushi me ngjyrë të zezë.

Dorashkat janë të qepura mirë dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e Policisë Bashkiake. Meshini quhet i cilësisë së parë kur ka të përpunueshme jo më pak se 80% të sipërfaqes kur është i

pangjyrosur dhe 90% të sipërfaqes kur është i ngjyrosur Tek meshini i ngjyrosur defektet lejohen deri në 20% të sipërfaqes. Tek lëkura e kurrizit (kruponi) defektet lejohen nga 5-10% të sipërfaqes.

Dorashka për Femra



Dorashka për meshkuj



Meshini është:

1. i butë,
2. me tollë (brumë) të fortë dhe të plotë,
3. i ngjeshur dhe kompakt,
4. i shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen.

Meshini ka:

1. rezistencë maksimale ndaj njollave, ujit dhe nxehtësisë,
2. ngjyrosje uniforme dhe të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen,
3. formë të rregullt.

Lëkura nuk egërsohet mbas lagies dhe montimit. Meshini i rezistonë tërheqjes dhe nuk çahet gjatë qepjes.

Tegelat e qepjes së dorashkave janë me hap 4 shpime në 1 cm.

Tegelat janë të drejtë, uniforme, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk kanë shqepje ose defekte.

Tegelat janë të fortë dhe nuk shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave është mbi 12N.

Tegelat janë të përforcuar në ekstremitete.

Të gjithë elementët e dorashkës janë simetrikë. Lëkura e dorashkës ka rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.

Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e dorezave është $\pm 2\%$.

Lëkura, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.

Për produktin e gatshëm paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:

- a. EN ISO 17234-1:2015
- b. EN ISO 17234 - 2:2011
- c. EN ISO 4045 - 2018 (vlera limit e pH për lëkurët që kanë kontakt direkt dhe jo direct me lëkurën është 3.5 - 7.5) Prodhuesi i artikullit të mësipërm është paisur me çertifikatën e standartit ISO 9001.

B. UNIFORMA SHËRBIMI VERE

Kostum uniforme(xhaketë,pantallona,këmishë,kravatë,kapele,këpucë)

1. _Pantallona Verore ngjyrë blu e errët.

Këto specifikime përcaktojnë kërkesat cilësore për prodhimin e pantallonave të verës të Policisë Bashkiake me tekstil të tezgjahur, ngjyrë blu i errët, cilësi e parë.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrës fizike (një palë pantallona vere, numur gjoksi 52 (170 -172 cm, prerja e tretë), të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me një pjesë lëndë e parë me gjatësi 0.3 ml (tekstil blu i errët) dhe gjerësi sa vetë tekstili.

Mostra e sjellë nga prodhuesi dhe të miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas kërkesave do të shërbejë si bazë për prodhimin e pantallonave.

Mostrat e sjella duhet të jenë qepur me penj të kuq, mosparaqitja përbën kusht skualifikimi.

Prototipi duhet të shoqërohen me vulën dhe etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar.

Skeda teknike të tekstileve të përdorura për prodhimin e këtij artikulli, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Specifikimet	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit	ISO 1833	53% Poliester (± 3%) 45% Lesh (± 3%), cuklim i ultë,2% Ela
Ngjyra e pantallonave		CIE L*a*b* D 65 10 Deg DE <1.5 Blu e errët
Masa	ISO 3801 PART III	220 g/m ² (± 5%)
Diametri i fijeve të leshit	ISO 137	21,5 µm (± 1 µm)
Endja (thurja)		Endje e thjeshtë
Numri i fijeve për cm	ISO 2060	Vertikal: 26/cm (± 1) Horizontal: 22/cm (± 1)
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 55 daN Horizontal: min. 45 daN
Cuklimi	ISO 12945-1	Pas 18.000 cikleve: 4 – 5 Pas 36.000 cikleve: 4
Qëndrueshmëria në abrazion	ISO 12947-1,2 dhe 4	>20.000 cikle
Këndi i rikuperimit	ISO 2313	Vertikal: min. 150° Horizontal: min. 150°
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077	Vertikal: < 1,5 % Horizontal: <2,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105 C06	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të lagshtë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj pastrimit kimik	ISO 105 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4

Trajtimi final (angl.: finish) pluhurit		Zmbrapës i ujit, vajrave dhe
Testi i spërkatjes (zmbrapsës i ujit)	ISO 4920	4
Zmbrapsmëria ndaj vajit	ISO 14419	4

Xhepat e Pantallonave

Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit	ISO 1833	65% Poliester (± 3%) 35% Pambuk (± 3%) Blu e errët
Ngjyra		110 g/m ²
Masa	ISO 3801 PART III	
Endja Linen		
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 60 daN Horizontal: min. 35 daN
Qëndrueshmëria e qepjeve në shkarje	ISO13936-1 në 3 mm	Vertikal ≥ 100 N Horizontal ≥ 200 N
Stabiliteti dimensional pas larjes në30°C	ISO 5077	Vertikal < 1,5% Horizontal: < 1,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105 C06	4 – 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit	ISO 105 X12	4 – 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4 – 5
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj pastrimit kimik	ISO 105 D01	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës	ISO 105 E04	4 – 5



Pjesa para

Pjesa prapa

DIZAJNI

Pantallonat janë model klasik, me dy xhepa të pjerrëta në anë, me dy xhepa në pjesën e pasme, mbyllja e pantallonave është me zinxhir, pantallonat janë me shtrat të lartë. Qemeri është e përbërë nga 6 ylykë. Dy xhepat anësor kanë një hapje prej 17 cm dhe hapsirë prej 3 cm. Dy xhepa

të pasëm janë pa kapak me fileto. Mbyllja e xhepit është me kopsa të thjeshta. Shiriti i belit është i pajisur me dopio astar, i cili është i lartë 4 cm. Mbyllja e pantallonave bëhet me gërma metalike. Pantallonat për femra kanë konstrukcion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.

2. Fund për Femrangjyra blu e errët

Specifikat	Normat	Rezultatet
Përbërja e materialit	ISO 1833	53% Poliester (± 3%) 45% Lesh (± 3%), cuklim
i ultë 2% Elastan		
Ngjyra e pantallonave		CIE L*a*b* D 65 10 Deg
DE <1.5		
Masa	ISO 3801 PART III	Blu e errët 220 g/m ² (± 5%)
Diametri i fijeve të leshit	ISO 137	21,5 µm (± 1 µm)
Endja (thurja)		Endje e thjeshtë
Numri i fijeve për cm	ISO 2060	Vertikal: 26/cm (± 1) Horizontal: 22/cm (± 1)
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: min. 55 daN Horizontal: min. 45 daN
Cuklimi	ISO 12945-1	Pas 18.000 cikleve: 4 –
5		
Qëndrueshmëria në abrasion	ISO 12947-1,2 dhe 4	Pas 36.000 cikleve: 4
Këndi i rikuperimit	ISO 2313	>20.000 cikle Vertikal: min. 150° Horizontal: min. 150°
Stabiliteti dimensional pas larjes në 30°C	ISO 5077	Vertikal: < 1,5 % Horizontal: <2,5%
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	5
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 30°C	ISO 105 C06	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të thatë)	ISO 105 X12	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të lagshtë)	ISO 105 X12	4
